

1.000.000.000€

2.000.000.000€

3.000.000.000€

ALARM 12

MATEMATIKA ZBAVITËSE



PARA ZGJEDHJEVE TË 2013 - BORXHARRJE:

Për vetëm tre muaj parazgjedhor, nga dhjetori i vitit 2012 deri në shkurt të vitit 2013, Qeveria ka marrë borxh **1.148.400.000€**. Në vend morri borxh **654.700.000€**, ndërsa nga Banka Botërore, Banka Gjermane dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim morri borxh **493.700.000€**.



Për vetëm tre muaj parazgjedhor, Qeveria i futi në borxh qytetarët e mitur dhe të rritur me nga **574,20€**.

Me këto borxhe parazgjedhore, borxhi i përgjithshëm i Qeverisë arriti në rreth **tre miliardë euro**! Por komonat? Borxhi i tyre ishte dhe mbeti fshehtësi.

PAS ZGJEDHJEVE 2013 - BORXHARRJE, PASTAJ SHPAGIM DHE SËRISH BORXHARRJE:

Për vetëm tre muaj pas zgjedhjeve, nga marsi deri në maj 2013, Qeveria fillimisht morri hua **140.000.000€**, pastaj ktheu **100.600.000€**, pastaj sërish morri hua **133.000.000€**, dhe sërish ktheu **2.000.000€**, dhe sërish morri hua **37.000.000€**, ndërsa ktheu **57.000.000€**, dhe pastaj morri edhe **57.900.000€**, dhe ktheu **33.800.000€**.

PARA ZGJEDHJEVE TË VITIT 2014 - BORXHARRJE:

Në janar, Qeveria morri hua **1.600.000€**, dhe morri edhe **23.300.000€**, sepse ka dashur të kthejë **3.500.000€**. Në shkurt morri hua **42.300.000€**, sepse është dashur të kthejë **27.700.000€**. Në mars morri hua **11.900.000€**, pastaj në prill morri hua edhe **93.000.000€**, sepse është dashur të kthejë pothuaj se **134.000.000€**. Më 15 prill, morri hua **25.000.000€**, sepse më 16 prill është



dashur të kthejë **25.000.000€**. Ndërsa, për herën e tretë në muajin e njëjtë, më 29 prill, Qeveria morri hua **46.400.000€**, sepse më 30 prill është dashur të kthejë **32.500.000€**.

Më 29 janar, Qeveria morri hua nga Banka Botërore në shumë prej **24.000.000\$**, ndërsa në shkurt morri hua **36.400.000€** nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në fund të muajit shkurt, borxhi i Qeverisë ka qenë **dy miliard e 807 milion euro** ose **35,2%** të BPV-së. Borxhi i komunave ishte dhe mbeti fshehtësi.

PAS ZGJEDHJEVE 2014 - BORXHARRJE VAZHDOJNË, JASHTË DHE BRENDA VENDIT:

Më 6 maj, Qeveria morri hua **101.000.000€**, sepse më 7 maj duheshe të kthejë **113.000.000€**, ndërsa më 20 maj, morri hua **30.400.000€**, sepse më 21 maj duheshe të kthejë **25.000.000€**. Për 5 qershor, Qeveria paralajmëroi marrje të një borxhi prej rreth **84.000.000€** sepse ka dashur të kthejë pothuaj se **85.000.000€**. Dhjetori është larg, ndërsa Kryeministri paralajmëroi zgjedhje të reja në shtator!



Ministria e Financave thotë që në mars, përqindja e borxhit të Qeverisë është rritur në **35,7%** të BPV-së. Të dhënat e muajit mars tregojnë që borxhi i brendshëm paraqet **një miliard e 587 milion euro**, ndërsa borxhi i jashtëm ka arritur nivelin e **një miliardë e 253 milion euro**. Secili qytetar i RM ka borxh **nga 1.420 euro**.

Gjatë pesë muajve të këtij viti, Qeveria futi në borxh çdo qytetar të mitur dhe të rritur të RM-së me nga **187,45 euro**.



Komisioni Evropian pret që borxhi i Maqedonisë të vazhdojë të rritet. Nga viti i kaluar, që ishte **36%** të BPV-së, këtë vit pritet që borxhi të rritet në **38,7%**, ndërsa vitin e ardhshëm **40,8%**. Ku është kufiri?

Ku janë borxhet e ndërmarrjeve publike dhe të komunave, pyeti ish guvernatori i Bankës Popullore, Petar Goshev, dhe përfundoi që të dhënat nuk janë transparente dhe që bëhet fjalë për manipulim.

Si bazë të këtij pohimit të tij mund të marrim shembullin e kredisë nga Banka Kineze Eksim në shumë prej **580.000.000€** për ndërtimin e autostradave Kërçovë - Ohër dhe Milladinovci - Shtip. Ky borxh do të jetë i Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore dhe jo i Qeverisë Qendrore.

PËRVEÇ TË HOLLAVE, QEVERIA KA BORXH EDHE PËRGGJIGJE

